

## PsikoBlogu

Kjo rubrikë ka për qëllim të shërbejë si një mundësi shtesë për të gjithë ata që duan t'i ofrojnë pikëpamjet e tyre personale apo profesionale rreth çështjeve të ndryshme të shëndetit mendor apo psikologjisë në përgjithësi.

Duke synuar promovimin e shpresës, ne inkurajojmë autorët e interesuar që të shkruajnë në një ton pozitiv përgjatë shtjellimit të çështjeve me rëndësi. Gjithsesi, ne mirëpresim të gjitha llojet e shkrimeve përderisa ato nuk promovojnë vlera stigmatizuese, diskriminuese dhe përjashtuese.

Shkrimet e dërguara rekomandohen të jenë informuese dhe të jenë të ndërtuara me nga **500 deri në 1500 fjalë**.

Të gjitha shkrimet tuaja mund t'i dërgoni në ***info@revistapsika.com*** me subjektin **“PsikoBlogu”**.

Disa parametra të tjerë me rëndësi:

- Mendimi juaj është burimi kryesor i blogut, por nëse do të parafrazoni, sigurohuni t'i përfshini referencat përkatëse.
- Referencat të cilat vendosen në shkrimet tuaja duhet të jenë kredibile dhe të marra nga burime të besueshme.
- Shkrimet të cilat shtejllojnë temën e vetë-lëndimit apo vetëvrasjes nuk duhet të ofrojnë detaje rreth mënyrave të vetë-lëndimit apo vetëvrasjes.
- Shkrimet të cilat përfshijnë persona të tjerë duhet ta respektojnë privatësinë e atyre personave.

## Rrëfimi im

Përgjatë kësaj rubrike do të pranohen dhe publikohen rrëfime personale të dërguara nga ata që duan të shkruajnë rreth përvojave të tyre me shëndetin mendor, përfshirë përvojat me simptoma, diagnoza dhe shërbime të caktuara.

Përmes kësaj rubrike, ne do t'i prioritizojmë përvojat e jetuara të personave me gjendje të ndryshme shëndetësore dhe çdo lloj neurodiversiteti.

Kjo rubrikë mirëpret edhe rrëfime nga perspektiva e profesionistëve shëndetësor, prindërve, kujdestarëve dhe edukatorëve.

Të gjitha shkrimet tuaja mund t'i dërgoni në [info@revistapsika.com](mailto:info@revistapsika.com) me subjektin “**Rrëfimi im**”.

Disa parametra me rëndësi:

- Shkrimi juaj duhet të përmbajë maksimumi 1000 fjalë.
- Shkrimet të cilat përfshijnë persona të tjerë duhet ta respektojnë privatësinë e atyre personave.
- Përvojat tuaja janë burimi kryesor i shkrimit, por nëse do të parafrazoni, sigurohuni t'i përfshini referencat përkatëse.
- Shkrimet të cilat shtejllojnë temën e vetë-lëndimit apo vetëvrasjes nuk duhet të ofrojnë detaje rreth mënyrave të vetë-lëndimit apo vetëvrasjes.
- Nuk është e domosdoshme të keni përvojë në të shkruar. Ne mirëpresim çdo stil të të shkruarit.

## PsikArt

Rubrika “psikArt” është një ekspozitë dixhitale përmes të cilës do të ndahen poezi, poema e shkrime artistike, këngë, shkrime komike dhe satirike, filma, piktura e ilustrime të ndryshme, shoqëruar me interpretime dhe përshkrime se si ato ndërlidhen me përvoja të ndryshme të rrugëtimit tonë personal dhe kolektiv me shëndetin mendor.

Për t’iu bashkuar kësaj rubrike, ju mund të dërgoni:

- Këngë që ju ndëgjoni e të cilat lidhen me përvojat tuaja të shëndetit mendor;
- Veprat tuaja të artit kreativ, përfshirë fotografi dhe vizatime, të cilat lidhen me përvojat tuaja të shëndetit mendor;
- Poema tuajat të cilat tregojnë për përvojat tuaja të shëndetit mendor; dhe
- Forma të tjera të artit kreativ apo shkrimit artistik,

në [info@revistapsika.com](mailto:info@revistapsika.com), me subjektin “**psikArt**”. Në e-mail duhet ta shtoni edhe një përshkrim të asaj se si ndërlidhet vepra, kënga, shkrimi, filmi apo fotografia juaj, me përvojat tuaja të shëndetit mendor.

*\*Shënim:* Ju mund të zgjidhni nëse gjërat që i dërgoni në kuadër të kësaj rubrike do të publikohen me emrin dhe mbiemrin tuaj, me ndonjë pseudonim apo plotësisht anonim

## Shkenca Sot

Përmes kësaj rubrike do të bëhet ndarja e të rejave të fundit shkencore nga fusha e psikologjisë. Shtjellimi i evidencës së fundit përkrah të gjeturave të tjera të periudhave të ndryshme kohore, të cilat përkrahin apo sfidojnë të gjeturat aktuale, duke theksuar mesazhet kryesore nga ato të gjetura, do të jetë një tjetër karakteristikë e kësaj rubrike.

Për të kontribuar në këtë rubrikë, ju mund t'i dërgoni shkrimet tuajat që shtjellojnë evidencë shkencore mbi temat të ndryshme të psikologjisë në e-mailin [info@revistapsika.com](mailto:info@revistapsika.com) me subjektin “**Shkenca Sot**”.

Disa parametra me rëndësi:

- Shkrimet e dërguara rekomandohen të jenë të ndërtuara me nga 500 deri në 1500 fjalë;
- Shkrimet e dërguara duhet t'i përfshijnë referencat e studimeve të shtjelluara;
- Shkrimet e dërguara nuk duhet të promovojnë vlera stigmatizuese, diskriminuese dhe përjashtuese;
- Shkrimet e dërguara nuk duhet të promovojnë seksizëm, racizëm, homofobi, transfobi dhe gjuhë të urrejtjes; dhe
- Shkrimet të cilat shtjellojnë temën e vetë-lëndimit dhe të vetëvrasjes nuk duhet të ofrojnë detaje rreth mënyrave të vetë-lëndimit dhe vetëvrasjes